

VENDIM

Nr. 22, Datë 12.09.2012

MBI PROPOZIMIN E DHËNIES Z. CLAUDIO GUBITOSI TË TITULLIT "*DOCTOR HONORIS CAUSA*" NGA UNIVERSITETI I ARTEVE

Senati i Akademisë së Arteve në datën 12.09.2012, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN SE

A. Lidhur me kërkesat e parashtruara Senatit Akademik

1. Dekani i Fakultetit të Artit Skenik në Universitetin e Arteve i ka parashtruar Senatit Akademik të UART propozimin për dhënien e titullit "*Doctor Honoris Causa*" z. Claudio Gubitosi, krijues dhe Drejtor Artsitik i Festivalit "Giffoni Film Festival".
2. Gjithashtu, Universitetit të Arteve i është drejtuar me shkresën nr. 248 prot., datë 24.05.2012 Qendra Kombëtare e Kinematografisë (QKK), e cila parashtron propozimin për dhënien e titullit "*Doctor Honoris Causa*" z. Claudio Gubitosi.
3. Gjithashtu, Universitetit të Arteve i është komunikuar edhe një shkresë e datës 16.05.2012 nga "Forumi i Mbrojtjes së Autorëve të Audiovizualit Film & Video", që parashtron propozimin për dhënien nga Universiteti i Arteve të titullit "*Doctor Honoris Causa*" për z. Claudio Gubitosi.

B. Lidhur me parashikimet ligjore

4. Senati Akademik i Universitetit të Arteve duke qenë autoriteti më i lartë vendimmarrës në çështjet që lidhen me promovimin e personelit akademik si dhe dhënien e titujve akademik, ka marrë në shqyrtim kërkesat e paraqitura, me qëllim vlerësimin e veprimtarisë së z. Claudio Gubitosi dhe arritjen e një vendimi të arsyetuar lidhur me dhënien e titullit "*Doctor Honoris Causa*".



5. Ky titull është i parashikuar nga VKM 467, datë 18.7.2007 "Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për kualifikimin, shkencor e pedagogjik, të personelit akademik", në pikën 2.6 të të cilit përcaktohet se "Titulli "Doctor honoris causa" u jepet figurave të shquara të shkencës dhe shoqërisë, për kontribut të veçantë në zhvillimin e arsimit dhe të shkencës, si dhe në zhvillimin, në tërësi të vendit tonë. Ky titull jepet nga institucionet e arsimit të lartë, pasi të jetë marrë pëlqimi i Komisionit të Vlerësimit të Titujve Akademikë."
6. Në referim të dispozitës së mësipërme, Senati Akademik ka kompetencën të japë këtë titull për personalitete të shquara, duke marrë edhe miratimin e KVTA-së.

C. Lidhur me figurën dhe veprimtarinë e z. Claudio Gubitosi:

7. Z. Claudio Gubitosi është krijues dhe Drojtor Artistik i Festivalit "Giffoni Film Festival" (GFF), i cili është një festival shumë i njohur ndërkombëtar i filmit për fëmijë dhe të rinj. I krijuar që në vitin 1971 ky Festival, me një gjetje shumë të veçantë në mënyrën e vlerësimit të veprave filmike dhe dhënien e çmimeve, nëpërmjet përfshirjes së fëmijëve dhe të rinjve në juri, promovon një kategori të veçantë krijimesh. Gjithashtu, fëmijët dhe të rinjtë përfshihen në forume e debate social kulturore, të cilat janë pjesë e rëndësishme e brezit të ri.
8. Z. Gubitosi ka qenë promotor i prezantimit të filmit shqiptar në këtë ngjarje ndërkombëtare që në vitin 1983, ku jo pak herë, nëpërmjet konkurrimeve dinjitoze disa filma janë nderuar edhe me çmime. Çdo vit në këtë ngjarje marrin pjesë 10 fëmijë shqiptarë, të cilët prekin nga afër magjinë e kinemasë dhe përjetojnë një eksperiencë të veçantë të jetës së tyre, përfshi këtu shkëmbime të ideve dhe njohjen e kulturave të ndryshme të bashkëmoshatarëve nga shumë vende të botës.
9. Me mbështetjen e veçantë të z. Gubitosi, prej tetë vjetësh, Shqipëria është pranuar si pjesë e Giffoni World Alliance dhe në Shqipëri zhvillohet festivali "Giffoni Film festival - Albania", një ngjarje e rëndësishme në veprimtaritë kinematografike.
10. GFF ka bashkëpunuar me QKK, duke konkretizuar edhe disa projekte kinematografike. GFF do të jetë partner kryesor në realizimin e "Festivalit të 13-të Shqiptar të Filmit në 100 vjet pavarësi".
11. Në vitin 1971 Z. Gubitosi organizon edicionin e parë të festivalit për fëmijë e të rinj Giffoni Film Festival. Në vitin 1984 ai vjen për herë të parë në Shqipëri ku njihet me prodhimet e kinemasë shqiptare.

12. Në vitin 1985 organizon për herë të parë në edicionin e atij viti, paraqitjen e filmave shqiptarë, disa prej të cilëve u vlerësuan me çmime. Ndër to përmenden "Lulëkuqe mbi mure", "beni ecën vetë", etj.
13. Në vitin 1994 rinis bashkëpunimi me Radio Televizionin Shqiptar (RTSH) dhe Alba film Studio, duke mundësuar ndjekjen e festivalit nga kineastë dhe gazetarë. Në vitin 1997 z. Gubitosi fton për herë të parë një grup fëmijësh dhe të rinjsh shqiptarë për të qenë pjesë e jurisë ndërkombëtare, traditë e cila vijon edhe sot. Rreth 300 fëmijë shqiptarë kanë qenë pjesë e eksperiencës së këtij festivali.
14. Që prej vitit 1999 një nga ditët e festivalit i kushtohet kinemasë shqiptare, duke projektuar filma, duke organizuar workshope me producent e regjisorë. Në vijim z. Gubitosi organizon mjaft shkëmbime personalitetesh të shquara të artit italian dhe shtetit italian, duke promovuar kulturën shqiptare.
15. Në vitin 2005 z. Gubitosi bëhet iniciator i zhvillimit të një formati të GFF të titulluar Giffoni Shqipëria Film Festival, i cili organizohet me sukses prej 8 vjetësh në Shqipëri, në dy faza dhe në qytete të ndryshme të vendit. Pjesë e këtij festivali janë bërë rreth 35 mijë fëmijë e të rinj.
16. Në vitin 2008 z. Gubitosi organizon një workshop me studentë të regjisë së filmit dhe televizionit nga Universiteti i Arteve, duke ftuar disa prej tyre në ndjekjen e master class-eve që zhvillon Giffoni Experience. Në tetor 2011, ai realizon një takim të hapur me studentë të regjisë së filmit dhe televizionit në UART, duke shpalosur mundësitë që ofrojnë formate të tilla si GFF për promovimin e profesionistëve të rinj të arsimuar në shkollat e artit. Ai gjithashtu merr pjesë në shfaqjet premierë të punimeve të diplomës së studentëve, duke përzgjedhur tre nga punimet më të mira për tu bërë pjesë e konkurrimit në edicionin e 43-të të GFF në Itali.

Ç. Lidhur me vlerësimin për dhënien e titullit

17. Duke konsideruar parashtrimet e mësipërme, Senati Akademik vlerëson se veprimtaria e z. Gubitosi paraqitet e pasur nga këndvështrimi artistik, duke u shfaqur si një personalitet i spikatur dhe me vizion në zhvillimin e veprimtarive me drejtim kinematografik.
18. Z. Gubitosi gjithashtu paraqitet si një kontribuues i fuqishëm në promovimin e vlerave artistike të kinematografisë shqiptare, me theks të veçantë në kinematografinë për fëmijë, duke u angazhuar



në marrëdhëniet me Shqipërinë që prej një kohe, kur marrëdhënie të tilla nuk ishin të lehta. Ai shfaqet si promotor i kinemasë shqiptare për fëmijë në vitet kur vendi ynë kishte një izolim pothuajse të plotë nga bota e jashtme, duke u bërë në këtë mënyrë një urë komunikimi me kulturën dhe zhvillimet ndërkombëtare, nëpërmjet një shteti me potencial kulturor të padiskutueshëm siç është Italia.

19. Sot z. Gubitosi ka rritur ndjeshëm praninë e tij dhe të GFF në Shqipëri, duke e bërë vendin tonë pjesë integrale të një projekti ndërkulturor mjaft të gjerë, e duke i dhënë mundësi publikut shqiptar të jetë pjesë e zhvillimeve social-kulturore me karakter rajonal, evropian e më gjerë, duke mundësuar në të njëjtën kohë promovimin e kulturës, traditave, mënyrës së jetesës e veçantive të kombit tonë.

20. Në këtë pikëpamje Senati Akademik i Universitetit të Arteve ka bindjen e thellë se z. Gubitosi, nëpërmjet veprimtarisë së tij të gjithanshme, ka kontribuar gjerësisht në promovimin e kulturës dhe artit shqiptar, duke i bërë ato pjesë të shkëmbimeve dhe eksperiencave ndërkombëtare. Në këtë mënyrë z. Gubitosi përmbush kriteret e përcaktuar për dhënien e titullit "*Doctor Honoris Causa*" nga Universiteti i Arteve.

21. Për këtë arsye, bazuar në pikën 2.6 të VKM 467, datë 18.7.2007 "Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për kualifikimin, shkencor e pedagogjik, të personelit akademik", ,

VENDOSI

1. Ti kërkojë KVTA pëlqimin për dhënien nga Universiteti i Arteve, z. Claudio Gubitosi të titullit "*Doctor Honoris Causa*".
2. Rektori i Akademisë së Arteve i dërgon KVTA-së këtë Vendim.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE